

Fejton “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)”(4)

Frika nga të qenët minoritet

Me shpërbërjen e Jugosllavisë, së paku një pjesë e pothuaj secilit grup etnik në ish-Jugosllavi përnjëherë u bë i frikësuar se do të mund të hidhet përgjithmonë në statusin “e minoritetit”, të mbivotohet në zgjedhje, të largohet nga puna, dhe të diskriminohet në mënyra tjera

Kur komunizmi ra, vokabulari politik jugosllav i ndërtuar me kujdes u shpërbë. Konceptet më parë të papranueshme tash u bënë të favorizuara nga elitat e reja (antikomuniste), ndërsa shenjat verbale të socializmit, përfshirë fjalën “kombësitë” në kuptimin

e vjetër, u bënë të vjetëruara. Derisa madhësia e popullatës e kishte humbur rëndësinë e saj në socializëm, në demokarcinë nacionaliste ajo fitoi rëndësinë vendimtare. Tash vërtet ishte me rëndësi nëse shqiptarët përbënin 20 apo 30 apo 40 për qind të

popullatës së përgjithshme të Maqedonisë. Tash ishte me rëndësi nëse nataliteti i boshnjakëve do të rritej apo do të stagnonte. Së paku një pjesë e pothuaj secilit grup etnik në ish-Jugosllavi përnjëherë u bë i frikësuar se do të mund të hidhet përgjithmonë në statusin e “minoritetit”, të mbivotohet në zgjedhje, të largohet nga puna, dhe të diskriminohet në mënyra të tjera.

Dhe vërtetë, ka historianë që

konsiderojnë se frika ishte “përcaktuesi më i madh i nacionalizmit etnik në tërë rajonin”. Reagimet nga frika kishin deri diku bazë në fakte, por ato u intensifikuan nga liderët nacionalistë në Serbi dhe Kroaci dhe u ndoqën nga partitë politike në shtetet e tjera të reja. Mungesa e lidershit të moderuar sigurisht se e ka bërë situatën e minoriteteve edhe më të vështirë se që do të kishte qenë, por problemi kryesor ishte në kontraditën që qëndronte në qendrën e nacionalizmit.

Ideja e kombit nuk është e mundur nëse ekzistojnë ata që nuk janë pjesë e atij kombi. Prandaj, duhet të ekzistojë “tjetri”, përndryshe ideja e kombit nuk ka kuptim. Marrë parasysh popullatat e përziera në Evropën Lindore, krijimi i shteteve kombëtare në gjysmën e dytë të shekullit 19-të dhe në fund të Luftës së Parë Botërore, njëkohësisht ka krijuar edhe minoritete. Prandaj, çështja e statusit minoritar nuk ishte çështje anësore, por u ngrit nga

struktura fundamentale e sistemit shtet-komb në të cilin republikat e ish-Jugosllavisë befash, pa shumë përgatitje, dolën si shtete të reja të pavarura. Çështja e minoriteteve u shfaq në ish-Jugosllavi jo për shkak të natyrës së çuditshme të Ballkanit, por si pjesë e vazhdimësisë së një procesi të gjatë evropian të ripërshtimit të vijave kufitare përgjatë linjave etnike. Sikur që kolapsi i perandorisë shumëkombëshe të Austro-Hungarisë krijoi një situatë të dhunshme edhe për kombet e reja, edhe për minoritetet e reja në Evropën Lindore pas Luftës së Parë Botërore, ashtu edhe kolapsi i Jugosllavisë shumëkombëshe krijoi situata të vështira për popujt e saj në vitet 90 të shekullit të 20-të.

Çka ndodhi me kombet dhe kombësitë

Kur republikat jugosllave përnjëherë u transformuan në shtete të pavarura, sovrae, pjesëtarët e popujve dikur konstitutivë

(kombeve) e që nuk jetonin në entitetet amë përnjëherë u shndërruan në minoritete. Të deprivuar nga statusi i tyre si “popull konstitutiv”, të gjithë ata i konsideronin kushtet e reja si reduktim të statusit dhe të të drejtave të tyre. Liderët, edhe të Serbisë, edhe të Kroacisë, posaçërisht i kanë definuar popujt e vet si pronarë të ligjshëm të shtetit “të tyre”, derisa i klasifikonin popujt e tjerë që jetonin brenda kufijve të tyre thejst si qytetarë të atij shteti.

Kombësitë e humbën statusin e tyre, po ashtu, por, me përfshatim të shqiptarëve të Kosovës, ndryshimi tek ata ishte shumë më pak i dhunshëm dhe shkatërrues se sa ndryshimet që ndodhën tek popujt dikur konstitutivë.

Tri çështjet më të vështira minoritare që u ngritën gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë ishin ajo e popullatave të përziera në Bosnje-Hercegovinë, e minoritetit të numërt serb në Kroaci dhe e popullatës



Rasti i Kosovës është një i veçantë

Rasti i Kosovës është një i veçantë. Edhe para se republikat e Jugosllavisë socialiste të ristrukturojnë veten në shtete të pavarura, shqiptarët e Kosovës janë pajtuar se ata nuk mund të vazhdojnë të jetojnë si një minoritet në Serbi porse duan të krijojnë shtetin e tyre të pavarur. Kjo çështje komplekse, që ende nuk është zgjidhur përfundimisht, diskutohet në një raport të veçantë të Projektit “Iniciativa e intelektualëve”.

shqiptare në Kosovë nën Serbi. Çështja

(Nesër: Kush e justifikonte agresivitetin me refuzim të statusit të minoritetit? Cila ishte gënjeshtria që u përdor për të bashkuar serbët në Bosnjë? Çka thuhet vërtet në Deklaratën islamike të Alija Izetbegoviqit?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (6)

Jeta nën kërcënim

E qëlluan me plumba në gjoks dhe në qafë. Ende ishte gjallë dhe po përpëlitej në trotuar. Iu afruan që t’ia jepnin plumbin e vdekjes. Atentatori ia afroi revolën në tëmth. E tërhoqi këmbëzën dhe... klik. Nuk kishte më plumba

Al Capone e kishte urdhëruar vrasjen e Dion O'Banionit dhe menjëherë i kishte marrë kërcënimet e shokut të Dionit, Hymie Weiss, dhe të partnerit të tij, Bugs Moran. Emri i vërtetë i Weissit ishte Earl Wajciechowski. Partneri i tij George “Bugsy” Moran ishte një person jostabil, i paparashikueshëm dhe i dhunshëm.

Kur kërcënimet dolën në mejdan, mentori i Capones, Johnny Torrio, që ishte njeri jo i dhunshëm, u

frikësua dhe iku nga Chicagoja. Al Capone mbeti, por e shtoi numrin e truprojave. Brenda dy vjetëve të ardhshme, Weiss dhe Moran tentuan më se dhjetë atentate ndaj Capones. Historianja Bergreen thotë se Capone vetë nuk ka mbajtur fare armë zjarri, por gjithnjë ka qenë i rrethuar nga truproja të sertë. Në mesin e tyre ka qenë edhe truproja i tij kryesor dhe shoferi Sylvester Barton.

Në janar të vitit 1925, Weiss dhe Moran kishin tentuar edhe një

herë pa sukses ta vrisnin Caponen. Në atë kiamet e sipër, Johnny Torrio vendos të kthehet në Chicago me gruan e tij Annën. Vetëm dymbëdhjetë ditë pas atentatit të dështuar ndaj Capones, Weiss dhe Moran bëjnë atentat ndaj Torrios. Automobili i Torrios ishte parkuar para ndërtesës së tij. Anna kishte hyrë në ndërtesë, ndërsa Torrio kishte mbetur me valixhe. Në atë kohë, Weiss dhe Moran kishin dalë nga automjeti i tyre dhe kishin nisur të shtinin mbi automobilin e Torrios, duke kujtuar se ai ishte në automobil. Shoferi i Torrios mbeti i vdekur në vend. Torrio, ndërkaq, kishte mbetur i shtanguar nga frika pak hapa tutje. Bugsy Moran e pa se Torrio nuk ishte në automobil dhe qëllloi mbi të duke e qëlluar në gjoks dhe në qafë. Torrio ra në tokë. Bugsy Moran u afrua dalgadalë dhe ia afroi revolen në tëmth. E tërhoqi këmbëzën, por revolja nuk shkrep. Nuk kishte më plumba në karikator. U bë tollovi në lagje dhe Weiss e Moran u detyruan të iknin. Torrio mbeti gjallë dhe u dërgua në spital. Al Capone i shtoi masat e sigurisë për mikun e tij. Madje, edhe vetë flinte në të njëjtën dhomë me Torriorin. Torrio kishte qenë i lirë, pasi ishte



Hymie Weiss ishte betuar se do t’i vriste Al Caponen dhe Johnny Torriorin

liuruar me kaucion. Mirëpo, në gjyq u shpall fajtor dhe u dënua me nëntë muaj burgim. Posa u shërua, u dërgua prapa grilave. Capone e korruptoi shefin e policisë, në mënyrë që Torrio të ishte i sigurt në burg. Në burg, Torrio është trajtuar si mbret. Mirëpo, Torrio nuk e donte dhunën. Nuk mund të jetonte nën kërcënim. Vendosi të tërhoqej nga biznesi. Ai e thirri Al Caponen dhe i tha se krejt biznesin do t’ia linte atij.

Al Capone tani ishte bërë edhe zyrtarisht shefi i klubeve të natës, i kasinove, i shtëpive publike dhe i

reketit në qytetin e Chicagos. Pushteti i tij u rrit në mënyrë marramendëse. Veç kësaj, pas sulmit ndaj Torrios, Weiss dhe Moran ishin heshtur njëherë për njëherë.

(Në numrin e nesërm: Si ndërruan sjelljet e Capones? Kush e këshillonte? Si vazhdoi Capone biznesin me Frankie Yalen? Kush ishte Richard Lonergan dhe ku i fuste “hundët” ai? Çka është masakra e Adonisit? Kush e quajti Caponen “gangsterin më të madh në histori”?)

Gangsterë të tjerë të shquar

Brian Wright

Brian Wright i njohur me nokën “Milkman” (Tomlaxhiu) është shefi më i madh i bandave të drogës në Britaninë e Madhe. Qindra milionë funte mall (kokainë) ka kontrabanduar në Britani. Ka pasur merak të merrej edhe me bixhoz dhe me bastore të garave të kuajve, ndërsa është i njohur si njeri që “i ka ndrequr” rezultatet e garave. Policia britanike më 1996 e ka zbuluar një anije, në të cilën janë gjetur jo më pak se 600 kilogramë kokainë, me vlerë prej 80 milionë funtash. Është gjetur edhe një parashutë. Droga kishte arritur me parashutë nga aeroplani në anije dhe prej aty kishte hyrë në tregun britanik. Nëpërmjet kësaj anije u zbuluan dhe u burgosën shumë nga bashkëpunëtorët e Brian Wrightit, përfshirë edhe të birin e tij Brian Juniorin, i cili u dënua me 16 vjet burgim. Brian Seniori iku në Qipro, mirëpo është arrestuar më 15 mars të këtij viti (një muaj e gjysmë më parë) në Spanjë dhe është në proces e sipër deportimi i tij në Britani.